

LINDJA E NINULLA - ZAKONE, CEREMONI E RITE NE DEVOLL

Hysen KOÇILLARI

Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Devollit si krahinë etnografike është e njohur prej shek. XV. Territori që përfshin Religjioni i Devollit përfshin trevën gjeografike që zenë 44 fshatrat e qyteti Bilisht, sot njësi administrative Bashki me qendër në Bilisht, mban emrin e krahinës, Devoll, por afërsisht gjysma e fshatrave të krahinës, pas caktimit të vijës kufitare mes Shqipërisë e Greqisë, vitin 1924, iu shkëputën trungut Amë dhe mbetën brenda territorit shtetëror të shtetit fqinj. Në këtë trevë, pjesë e trungut të parailirëve-ilirëve-arbërve-shqiptarëve banojnë devollinjtë e sotëm. Mitologjia përcjell mite e legjenda për ilirët e fisin Dasaretas e Eordejtë. Hesiodi, shek. VIII p.e.s. dhe Alkmoni, shek. VII p.e.s. janë autorët e parë antikë që përmendin pellazgo-ilirët. Historia shënon shek. V p.e.s. si kohë kur Herodoti, babai i historisë, është i pari që përmend Ilirët. Po në këtë kohë Herodoti e Tukididi përmendin Eordejtë. Koha e pasuron vargun e autorëve që dasaretët e eordët i citojnë gjithmonë si pjesë të trungut të fiseve ilirë. Devollinjtë janë pasardhës të dasaretëve, dhe rrjedhojë e origjinës së tyre të përbashkët, gjuhës, zhvillimeve historike, kushteve ekonomiko-sociale të përafërta, pjesëtarë të së njëjtës mënyrë jetese të cilët krahas tipareve të përgjithshme etnike-kombëtare, formuan dhe tradita kulturore specifike. Kështu u krijua folkloristika, përfshi lirikën familjare. Këngët e Lindjes me zakone, ceremoni e rite që kryen gjatë realizimit të tyre e ninullat me mesazhet që përcjellin mund të jenë pasuria ndër më e vjetër në lirikën familjare. Pohojmë kështu sepse që në origjinë si subjekt kishin familjen e çdo krijim me përmbajtje për të mirë a të keq lidhej me individë të bashkësisë më të vogël të organizuar të shoqërisë primitive. Në punimin tonë argumentojmë që këngët e Lindjes e ninullat-zakone, ceremoni e rituale që kryhen gjatë zhvillimit të tyre etj, janë trashëgimi shpirtërore e trungut parailir-ilir, arbëror-shqiptar.

Fjalë kyçe: mit, legjendë, mitologji, Devolli, pagan, ninullë, zakon, ceremoni, ritual, “syri i keq”, magji.

ABSTRACT

Devoll, the ethnographic province is a region, which as an ethnographic unit has been known since the XV century. The territory where the population of Devoll is located includes the geographical area of 44 villages and the city of Bilisht, today the administrative unit of the Municipality based in Bilisht, with the name of Devoll province. Approximately half of the villages of this province, after the establishing the new boarderline between Albania and Greece, in 1924, were detached from the Motherland and remained within the territory of the neighboring state. In this area, part of the trunk of the pre-Illyrians-Illyrians-Arbers-Albanians, live the present-day Devollies. Mythology conveys myths and legends about the Illyrians of the Dasaret and Eorde tribes. Hesiod, c. VIII b.c. and Alcmoni, c. VII b.c. are the first ancient authors to mention the Pelasgian-Illyrians. History marks the V century b.c. as the time when Herodotus, the father of history, mentions for the first time the Illyrians. At the same time Herodotus and Thucydides mention the Eords. Over time the number of authors who cite the Dasarets and Eords as part of the trunk of the Illyrian tribes has increased. The Devollis are descendants of the Dasarets, that as a result of their common origin, historical developments, similar socio-economic conditions, same way of living who, in addition to general ethnic-national features, formed specific cultural traditions. This is how folklore was created, including family lyrics. The songs of the Child's Birth, with their richness in customs, ceremonies and rites performed, as well as the lullabies with the messages they convey, may be among the oldest assets in the family lyrics. We reason this way, because their subjects, from their beginning were focused on the family, and sll creation with their content for better or worse, were associated with individuals composing the smallest organized form of the primitive society. In our work we argue that birth songs and lullabies-customs, ceremonies and rituals performed,

etc, are the spiritual heritage of the pre-Illyrian-Illyrian, Arberian-Albanian trunk. Keywords: myth, legend, mythology, Dasaretët, Eord, Devoll, devollies, pagan, childbirth, lullaby, custom, ceremony, ritual, "evil eye",

Key words: *myth, legend, mythology, devoll, pagan, lullaby, custom, ceremony, ritual, evil eye, magic.*

HYRJE

Dh. Pilika, studiues, jep alarmin: “Mitologjia pellazge është krejt e pambledhur dhe e pastudiuar deri tani. Tek gjiri i popullit tonë flenë thesarë të vërtetë, që presin të futen sa më shpejt në qarkullim shkencor. Por kohët moderne, indiferente (për të mos thënë asgjësuese) ndaj kujtesës së popujve të vegjël, thesarët e këtij lloji i asgjësojnë i asgjësojnë shumë më shpejt se sa deri më tani, *ndaj duhet nxituar*. Ashtu sikurse helenocentrizmi, romanocentrizmi, europianocentrizmi i dikurshëm, globalizmi kulturor i sotëm është armiku më i madh i kulturave të popujve të vegjël dhe sidomos i trashëgimisë së tyre etnike, aq më tepër i saj që dergjet ende nën tokë dhe kësisoj nuk përmban ende ndonjë domethënie qoftë edhe komerciale, e cila do ta ruante gjithsesi, diku. ”Për trashëgiminë e lashtë tek ne shqiptarët shprehet dijetari francez Alber Omon më 1874: “asnjë komb i Evropës nuk ka zakone më të vjetra”. Rreth një gjysëm shekulli më pas, një arkeolog i huaj, njohës i mirë i traditave tona, do të nënvizojë për shqiptarët: “Ndër ta edhe sot janë në përdorim zakone të një kohe aq të vjetër, saqë vetëm në kohët homerike mund të gjenden”. Në punimin tonë do të shkruajmë për zakone, ceremoni, e rite që devollinjtë i kanë pjesë të trashëgimisë kulturore me origjinë prehistorike të lirikës familjare, të cilat i janë kushtuar gruas para, gjatë e pas lindjes dhe kujdesit për mirërritjen e foshnjës, ninullave, këngëve të djepit, që u këndohen fëmijëve të moshës 0-3 vjeç, përfshijmë dhe këngët me përmbajtje përkëdhelie e përmbajtje loje e ato me subjekt humoristik që praktikohen e zhvillohen me fëmijët e moshës 3-5-6 vjeç.

LINDJA E NINULLA - ZAKONE, CEREMONI E RITE NE DEVOLL

1. Mite për origjinën e ilirëve, dasaretëve e eordejëve-zakone

1.1 Tregime mitologjike për ilirët dhe dasaretët

Mitologjia merret me studimin e miteve. Ajo rikrijon atmosferën e shenjtëruar të kohëve mitike dhe paraqet protagonistët e bëmat e tyre...është e rëndësishme për njohjen e historisë së tyre. Historia, kjo shkencë për të kaluarën, duhet të përdorë metoda shkencore për të studiuar të kaluarën. Faktet mitike janë për historianët ngjarjet e para për të kaluarën.”¹ A. Spahiu shkruan: “Mitet dhe legjendat përbëjnë një mënyrë, me anën e së cilës popujt përfytyrojnë historinë e tyre. Faktet e vjetra mitologjike do të ishin ngjarjet e para të parahistorisë. Historianët, duke i ndërthurur rrëfenjat e ndryshme mitologjike, kanë formuar historicizmin e mitit. Pastaj, me kohë, ia kanë aneksuar përfundimisht mitin historisë.

Lidhur me prejardhjen e një populli ose themelimin e një qyteti, mitologjia prirret t’i afrohet historisë.² Koha e formimit të rrëfimeve të para mitologjike, siç është vërtetuartashmë nga shkenca, i përket periudhës së paleolitit. Mitologjia ishte dëshmi e rëndësishme e një




1. A. Spahiu “A. Spahiu “Pellazgët dhe ilirët në Greqinë e vjetër”, Tiranë, 2006, fq. 46.

2. Po aty, fq. 19-20

hopi të madh të bërë nga bashkësia njërezore primitive, për t'u shkëputur nga jeta e egër, për t'u shoqërizuar.”³

Krahina e Devollit shtrihet në një territor ku një pjesë në lashtësi popullohej nga etni ilire, nga Dasaretët, pjesës më perëndimore e saj, konkretisht, zona që ze Devolli i sotëm. Pjesa tjetër e krahinës popullohej po nga etni ilire të fisit të Eordejve, skajit më lindor i saj, sot territor në Greqi. Mbështetur, veç mitologjisë, por nga të dhënat e faktet shkencorë të historisë, gjeografisë, gjuhësia, arkeologjisë, etnografisë etj. synojmë që në punimin tonë të argumentojmë që në këto territore etnikë të populluar nga banorë autoktonë paralirë-ilirë-arbërorë-shqiptarë janë rrënjët e devollinjëve.

Apollodori, shek. IV p.e.s, thotë: “ILLYROS, kryefisi i fisit ilir, është i biri i Fenikasit Kadmi e i së shoqes së tij Harmonisë. Me urdherin e babait të tij, Agenorit, mbretit të fenikasve, Kadmi, nisët për ta gjetur të motrën e vet, Evropën, që e kishte rrëmbyer Zeusi.



Mbas



shumë bredhjeve, duke mos mundur të vendoste që të kthehej pa kryer punën në atdhe sëbashku me shokët e vet, është ndalur në Beoti të Greqisë e aty themeloi qytetin Teba. Duke u martuar me Harmoninë, me të bijën e perëndisë të luftës, Aresit e perëndeshës Afërdita, Kadmi shkoi me urdherin e profetit në mesin e enkelejve ilirë e u bë mbreti i tyre. Aty, në tokën e ilirëve, i lindi i biri Illyrios, sipas të cilit ilirët morën emrin. Në pleqëri Kadmi e Harmonia u shëndrruan në gjarpërinj e në atë formë kanë vazhduar të jetonin në fushat e Elizesë.”⁴

Apiani, 95-160 pas Krishtit, “Luftrat ilire” pohon: “Këtë emër e mori ky vend (ILIRIA- H. K.), siç

thonë, nga Iliri. Bijtë e qiklopit Polifem dhe Galatës, të quajtur Kelt, Ilir e Gal, lanë Sicilinë e u bënë sundimtarë mbi fisa, që nga emrat e tyre u quajtën keltë, ilirë e galë. Nga shumë legjenda që tregohen, kjo më pëlqen më tepër. Bijtë e Ilirit kanë qënë Enheleu, Autari, Dardani, Medi, Taulanti e Perrebi; vajzat e tij ishin Parta, Daorta, Dasara, e të tjera, nga kanë ardhur taulantët, perrebejt, enhelejtët, autariatët, dardanët, parthinët, dasaretët (theksimi H. K.) e darsejt. Thonë se



3. A. Uçi “Mitologjia, Folklori, letërsia”, Tiranë, 1982., fq. 15.

4. A. Steptoviq “ILIRËT- historia, jeta, kultura, simbolet e kultit”, Tiranë, 2002, fq. 15.

Autari pati për bir Panonin, ose Paionin, e ky i fundit pati për bij Skordiskun e Tribalin, nga të cilët morën emrat të dy fiset. Por, unë do t'ia lija këto çështje arkeologëve.”

A. Kola, arvanit, për zanafillën mitologjike të ilirëve shkruan: *Miti thotë se babai i Kadmit, Agenori, u largua nga Greqia e shkoi të mbretëronte në Feniks*. Kur perëndia u shndërrua në dem e grabiti vajzën e Anigorit që ishte dhe e motra e Kadmit. Ageori dërgoi djemtë e tij që ta kërkojnë dhe të mos kthehen pa të. Kadmi u end më kot, deri sa mori një profeci nga Orakulli i Delfit që thuhet se duhet të ndalonte kërkimin e së motrës e të ndiqte delen e parë që do të takonte rrugës dhe se aty ku ajo do të ndalonte, të ndërtojë një qytet. Që të mos e zgjasim, delja ndaloi diku në Bioti dhe aty Kadmi ndërtoi qytetin, të cilit i dha emrin e tij. Por, nga që nuk kishte banorë, vrau dragoin që ruante Kroin e Perëndisë së Luftës (Arit) dhe sipas këshillës së perëndisë së diturisë (Athinasë), i mbolli dhëmbët e tij nga të cilët lindën njërezit. Kadmi mori për grua Harmoninë dhe djali i tij, Iliri, u bë krijuesi dhe prijesi i Ilirisë (theksimi H.K.) meqënëse një teban quhet prind i krijuesit të Ilirisë.

E. Jacques, studiues amerikan, thotë: *Pirro, biri i Akilit legjendar, është i pari person gjysëm legjendar e gjysëm historik që e kapërceu kufirin e legjendës së mjegullt dhe i mbledhi sëbashku fiset e shpërndara pellazge*. Menjëherë pas rënies së Trojës që, sipas traditës, datohet rreth vitit 1284 p.e.s, Pirro Neptolemi, djali i Akili, erdhi në pjesën jugperëndimore të gadishullit dhe i bashkoi luftëtarët pellazgë të asaj treve nën udhëheqjen e tij. Kjo është treva që sot njihet nga shqiptarët Toskëri. Këto fise përfshinin thesprotët e Sarandës e të Camërisë që shtriheshin në jug deri në gjirin e Artës, kaonët e Kurveleshit e të Himarës apo të Labërisë, atintanët e Përmetit e të Tepelenës, si e dasaretët (theksimi -H.K.) e Beratit dhe të trevave të sotme të Ohrit e të Korçës.”

1.2 TREGIME MITOLOGJIKE PËR EORDËT E E ZAKONE TË TYRE

Herodoti, shek. V p.e.s., përcjell një legjendë për lindjen e Eordas: “Perdika, i biri i shtatë i këtij Aleksandri, është ai që ndërtoi në këtë mënyrë shtetin e maqedonëve. Prej Argo shkuan tek ilirët tre vëllezër pinjollë të Temenit: Gauani, Aeropi, dhe Perdika; dhe duke ikur nga ilirët u vendosën në Maqedoninë e Sipërme në qytetin **Lebaia** (theksimi -H. K.). Këtu ata shërbenin me rrogë tek mbreti, njëri duke kullotur kuajtë, tjetri gjedhët, kurse i vogli prej tyre, Perdika, qingjat”. Nga historia dimë që qyteti Lebaia ishte kryeqendra e mbretit të Maqedonisë që thirrej Emathi. Më pas Eleova mbeti fshat me emrin Eleova. Historia përcjell që deri rreth vitit 1878 i përkiste kazas së Kosturit. Këtë përfundim e përforcon dhe kqyrja e studimit të kryer nga L. Jankovski e A. Bakratcheff: “Emrat e qyteteve e të fshatrave të trevave të Shqipërisë, Maqedonisë të pushtuara nga Greqia më 1912, të të cilëve u është ndërruar forcërisht emri që nga viti 1926 e në vazhdim”. Studiuesit përkrah emrave tradicionalë shënojnë emrat grek, me të cilët i zevendësuan dhe shkruajnë: “Eleova i përkiste Kosturit me emrin Lakia, e cila më pas mori emrin Levaia, që do të thotë se kemi të bëjmë me Eleovën dhe jo me Elevis, siç shkruan studiuesi grek Dh. Lithoksu. Ne e kundërshtojmë këtë në bazë të burime shkencore që Eleova është quajtur Lakkia dhe më vonë Levaia”.

K. Rufi, shek. I e. sonë, historian romak, “Historia e Aleksandrit të Madh”, shkruan: “Kështu, pasi autariatët ishin rregulluar, pa qënë nevoja për të luftuar me ta, Ai (Aleksandri -H. K.) **arriti në Pelion, që është një qytet i Dasaetisë** (theksimi -H.K.) mbi lumin Eorde. Armiqtë u dukën sikur do të luftonin e nxorrën me furi garnizonin gati për të filluar betejën, por para se të ndesheshin u tërhoqën megjithëse kishin zënë pozicione të përshtatshme, pyje e rrugë. Maqedonasit panë një gjë të tmershme në këtë vend: tre djem të rinj e tri çupa të reja të shtrirë të vdekur në tokë, bashkë me tre desh të zi, gjaku e trupat e të cilëve ishte përzier. Barbarët u kishin bërë fli perëndive të tyre sipas një besimi të shenjtë, për t'u dhënë guxim njërezve të tyre që do të luftonin”.

Arriani, shek. II e. sonë, “Fushata e Aleksandrit”, tregon: Aleksandri, pra, po marshonte (në praverën e vitit 335 p.e.s.-H. K.) kundër qytetit (Pelionit - H. K.); Armiqtë (Dasaretët-H.K.) atëherë bënë fli tre djem, tri vajza dhe tre desh të zinj dhe vendosën t’i presin maqedonasit e të përleshesh me ta. Po me të filluar beteja, i lanë viset që kishin zënë, megjithësej ishin të forta, dhe iknin aq shpejt sa edhe kufomat e flive u gjetën të shtrira e të paprekura”.

***Sh. Ollomani**, studiues shqiptar në Maqedoni, shkruan që Mbretërinë Maqedonase e themeloi Perdika I, i cili mbretëroi rreth viteve 700 p.e.s. Legjenda përcillet sipas variantit: “Perdika erdhi nga Iliria me vëllezërit, Aeoropin e Gavanin dhe u vendosën në Maqedoninë perëndimore, u bënë barinj të kopeve të mbretit të Lebajës. Një natë mbreti pa në ëndërr që Perdika po i merr fronin, prandaj vendosi t’i vriste vëllezërit. Perdika me vëllezërit një ditë kur ishin duke kullotur kopetë, panë nga larg kalorësit që kishte dërguar mbreti për t’i vrrarë. Ata dyshuan në ata e ikën. Nga prapa u vinin shigjetat që hidhnin kalorësit. Pas një ikje të gjatë, arritën te një lumë e u hodhën për të shpëtuar, dhe dolën në anën tjetër. Pak kohë pas tyre erdhën edhe kalorësit që u futën në lumin e cekët për të dalë në anën tjetër. Por, befas një rrymë e fuqishme uji ra sipër tyre dhe i mbyti. Më vonë Perdika gjeti shokë, u bë i pasur dhe u kthye në Lebajë dhe pasi mundi mbretin e Lebajës, ia mori fronin”.

3. HISTORIA E ARKEOLOGJIA PËR ORIGJINËN E DASARETËVE E TË EORDËVE

Alkmani, VII p.e.s., shkruan të dhëna më të vjetra për **ilirët** (theksimi - H.K.) që i gjejmë në vargjet e Alkmanit, poet i njohur grek.”⁵

Herodoti, shek. V p.e.s. “Historitë” është historiani i parë që për të treguar thellësinë e tokave ilire përdori togfjalëshin “tokave ilire”.⁶ Dhe në fq.21 citon ilirët: “Prej Argo shkuan tek **ilirët** (theksimi H.K.) tre vëllezër pinjollë të Temenit: Gauani, Aeropi e Perdika.

Herodoti, shek. V p.e.s., pohon: “Maqedoni: Eordët, Botianët, Pelagonët, Pierët.”⁷

Tuididi, shek. V p.e.s., shkruan: “Maqedoni: Eordët, Botianë, Pierë.”⁸

Ptolemeu, shkruan: Vendi që ze Maqedonia, shkruan: “23. Në tokën e **eordejve** (eordaioi)...; dhe në vijim: “29. Në tokën e **dasaretëve** (dasaretioi)...(dy theksimet -H.K.)”⁹

1.4. POHIME NGA STUDIMET PËR GJETJET ARKEOLOGJIKE NË DEVOLL

Popujt kanë prejardhje gjenetike prej të cilave trashëgojnë origjinën , territorin, gjuhën, kulturën materiale, shpirtërore e sociale dhe, në disa raste edhe emrin e tyre. **M. Aref**, “Mikenët=Pellazgët, Greqia ose zgjidhja e një enigme”, Plejad, 2008, në Kapitullin III “Antropologjia dhe arkeologjia parahelene” shkruan:

Paleolitik i mesëm dhe i vonshëm: rreth 12,000-10,200.

Mesolitik – 10,200-6500 thotë se kjo periudhë është gjithashtu ajo e zhvillimit të nën-specias së fundit njërezore: Homo Sapiens. Ekzistojnë në Shqipëri shpella të shumta që datojnë që nga kjo epokë dhe ka

5. A Stipçeviq “ILIRET-historia, jeta, kultura, simbolet e kultit”, Tiranë, 2002, fq. 22.

6. Ilirët dhe Iliria te autorët antikë”, Botimet Toena, Tiranë 2002, fq. 17

7. M. Aref “Mikenët=Pellazgët, Greqia ose zgjidhja e një enigme”, Plejad, 2008, fq. 70.

8. Po aty, fq. 80.

9. Ilirët..., vepër e cituar, fq. 268.

të ngjarë nga periudha të mëparshme. Ja zonat prehistorike që datojnë me këtë periudhë: Fushë Muher (verilindje e Shqipërisë, pranë Peshkopisë). Velça (perëndim i Tepelenës). *Treni (jug-perëndim i liqenit të Prespës së Vogël) - theksimi - H.K.*” Spileja (perëndim i Gjirokastrës)”.

Neolitiku dhe kalkolitiku 6500-2500.

Zonat parahistorike më të njohura janë: Cakran, Maliq e Dunavec (theksimi H.K.). Nga tre zona dy janë në territorin, që dikur shtrihej Dasaretia.



Neolitiku i Lashtë: Kolsh I, Bllacë II, Cetush, Burim (dikur thirrej Gollobërdë -H.K.), Podgori, Tren I, Vashtmi, Barç I, Vlush II (theksimi -H.K.). Nga tetë zona të cituara pesë janë në territorin, që dikur shtrihej Dasaretia, një në Devollin e sotëm.

Neolitiku i Mesëm: Zonat kryesore: Kolsh II, Bllacë III, Cakran, **Dunavec** (theksimi -H. K.). Nga pesë zona të cituara një është në territorin, që dikur shtrihej Dasaretia.

Neolitiku i Vonë: Zonat kryesore: Maliq I, Barç II, Dersnik, Velçë. Kamnik (theksimi- H.K.). Nga pesë zona të cituara katër janë në territorin, që dikur shtrihej Dasaretia.

Kalkolitiku Zonat kryesore: Nezir II, Bllacë IV, Gradec, Burimas, Maliq II, Tren II (theksimi H. K.). Nga gjashtë zona tre janë në territorin kushtrihej Dasaretia, një në Devoll.

Epoka e Bronzit Gjithsesi, arkeologët shqiptarë e vendosin Epokën e Bronzit në Shqipëri në vitet 2100-1000. Zonat kryesore në Shqipëri:

Bronxi i Lashtë: Jug: Pazhok, Maliq III a-b, Tren III, Luaras (theksimi -H.K.), Piskovë. Nga pesë zona tre janë në Dadareti, një në Devoll.



Bronxi i Mesëm: Jug: Pozhok, Maliq IIIc (theksimi -H. K.), Vajzë, Vodhinë, Çukë, Bajkaj. Nga gjashtë zona një është ku shtrihej Dasaretia.

Bronxi i Vonë: Jug: Pozhok, Gërmenj, Maliq III d, Tren IV, Luaras (theksimi -H. K.), Piskovë, Badhër. Nga shtatë zona katër janë ku shtrihej Dasaretia, një në Devoll.

Epoka e Hekurit – 1000 / 900 – 500: Zonat kryesore: Jug: Gërmenj, Belsh, Patos, Kuç i Zi, Barç, Vajzë, Rehovë, Benjë, Prodan (theksimi H.K.), Piskovë, Vodhinë, Bajkaj. Nga njëmbëdhjetë zona katër janë ku shtrihej Dasaretia.”.

Nga hulumtimet tona rezulton që kjo është tabela më plotë e Epokave që ka kaluar njërëzimi e shoqëruar me zonat më të rëndësishme arkeologjike të selisë, ka edhe studiues të tjerë që kanë shkruar por përcjellin të dhëna të pjesëshme e për epoka të veçanta. E cituam të plotë pasqyrën se nga kqyrja nxjerrim përfundime që ndihmojnë për punimin tonë studimor.

Së pari nga 61 zona të rëndësishme arkeologjike që citohen për të gjitha epokat 33 të tyre gjenden në treva të vendit tonë dhe 28 ose 42% e tyre ndodhen në territorin ku në lashtësi zinin vend Dasaretët, fisi paraardhës i devollinjëve. Ky numër i madh zonash të studiuara në Dasareti përcjell të dhëna për origjinën prehistorike të devollinjëve, faktor që ndikoi gradualisht për të formuar etnokulturën, pasurinë shpirtërore të pasur me doke, zakone, ceremoni e rite.


Së dyti, listën e zonave të rëndësishme citohet në katër raste stacioni arkeologjik i Trenit, fshat që sot është territor i Devollit. Vlerë ka pohimi, pas studimit të materialeve të zbuluara në Shpellën e Trenit është vendbanim prehistorik që daton i Masolitikut 10200-6500 mbetjet e të cilit korrespondojnë prej Neolitikut në vazhdimësi me ato të epokave të bronxit e hekurit.

M. Korkuti, arkeolog, përgjegjës i disa ekspeditave arkeologjike në Tren, shkruan: “Në vendbanimin e Trenit gjurmimet u zhvilluan në dy sektorë: në Shpellë (sektori A) e në banimin sipër shpellës (sektori B) Në të dy sektorët e gërmuar u fiksuan si stratigrafisht, ashtu edhe nga lënda arkeologjike, këto periudha banimi...Gjurmët më të hershme të banimit i takojnë eneolitit të vonë”.

B. Coviq, thotë Qeramika Devollite “është ilire për arsyen e thjeshtë, sepse qendra e parë e formimit dhe e zhvillimit të saj shekullor ndodhet në krahinën e Devollit, e cila është ilire”.

E. Jacques, studiues amerikan, pohon: “Kjo qeramikë e “Devollit” do të përhapej me shpejtësi kudo, duke u shndërruar në tipar dallues i kulturës së Kohës Bakrit.” Në vijim shkruan: “Një shpellë natyrore me gjurmë vendbanimi, gjatë viteve të Neolitit të vonë, u gjet në Tren, pranë liqenit të Prespës së Vogël, afër Korçës. Aty, rastësisht, mbi të ashtuquajturin Shkëmbi Spile, ndodhet afresku më i vjetër i njohur në Shqipëri, që datohet rreth vitit 1100 p.e.s”.

Zh. Andrea, akeologe, konkludon: “Qeramika e zbuluar është zbuluar për herë të parë në shtresën e bronzit të vonë në vendbanimin e Maliqit (sipas F. Prendi) e më vonë në atë të Trenit (fshat në Devoll-H.K.) (sipas M. Korkuti), të cilët ndodhen në rrjedhën e sipërme të lumit Devoll. Mbi origjinën, kohën e përdorimit dhe përkatësinë etnike të qeramikës së pikturuar është diskutuar mjaft në literaturën e vjetër e të re dhe janë shfaqur mendime të ndryshme që njihen nga specialistët dhe mbi të cilat ne nuk do të ndalemi këtu. Midis studiuesve të huaj që janë marrë direkt me këtë problem përmendim: H. A. Heuerley, S.I. Dakaris, profesor Grashanin e profesor N.G.L. Hammond. Për “qeramikën devollite” janë shprehur arkeologët F. Prendi, M. Korkuti, Zh. Andrea, N. Ceka, etj. të cilët argumentojnë se është me origjinë ilire, dhe vendlindjen e saj e vendosin në pellgun e Korçës e të Devollit. Është shprehur mendimi se krijues e bartës të qeramikës së pikturuar ka qënë ajo popullsi që në burimet e shkruara përmendet me emrin Dasaretët.



2. MBETJE TË HERSHME TË TRASHËGIMISË FOLKLORISTIKE TËLINDJES E TË NINULLAVE NË ZAKONE, CEREMONI E NË RITUALE

2.1. VEÇORI TË PËRGJITHSHME TË KËNGËVE TË LINDJES E TË LINDJES

Banorët e krahinës së Devollit, rrjedhojë e lidhjeve të gjata midis tyre, të origjinës, të zhvillimeve historike, të kushteve ekonomiko-sociale të përafërta e mënyrë jetese të njëjtë, krahas tipareve të përgjithshme etnike-kombëtare, u formuan edhe tradita etnokulturore specifike që ndikoi në formësimin e emrit që mban kjo njësi territoriale. Tradicionalisht, banorët e komunitetit devollit janë të njohur për

krijimin në familje të marrëdhënieve sociale pozitive midis meshkujve e femrave. Bile, mund të pohojmë që krahasuar me disa krahina të vendit tonë, për shkaqe të ndryshëm historiko-socialë, Devolli, përgjithësisht, ka qënë më i empacipuar. Prej thellësive të shekujve e në vijimësi, na vinë “thërrmijëza” nga krijimtaria kulturore, ndonëse në përmbajtje patën rol fetë monoteiste, që në subjektet e tyre kishin tema që lidheshin me jetën e përditshme të familjeve e të fiseve. Këtu lindi e u pasurua ajo pjesë e folkloristikës që quhet lirikë familjare. Një lloj i saj janë këngët kushtuar Lindjes, zakoneve, ceremonive, ritualeve dhe ninullave. Këngët që i kushtohen lindjes, ndoshta, bashkë me ninullat janë më të hershmet në fondin e lirikës familjare. Lindja e fëmijës si dukuri parësore për ripërtëritjen e jetës, kurdoherë ka qënë e është një nga ngjarjet më të shënuara e më të gëzueshme në jetën e një familje.

Studiues muzikologë e specialistë të folkloristikë pohojnë: “Ashtu sikurse llojet e tjera të lirikës familjare edhe këngët e Lindjes janë shumë të hershme, bile, mund të themi se këto, së bashku me ninullat, mund të jenë nga më të vjetrat në lirikën familjare”. Gjatë viteve 1996-2014, periudhës kur fshat më fshat të Devolli realizova dhjetra ekspedita kërkimore për të eksploruar pasurinë folkloristike e të dhëna me karakter historiko-fetar për të shkruar Triptikun “Të njohim Devollin”, realizova anketa, takime e bashkëbisedime. Qëllimi ishte, veç të tjerave, evidentimi i pasurisë shpirtërore, pasurisë zakonove e ceremonive e riteve që kryen në Devoll për ngjarje të shënuara të jetës. Në librin “Pasuria shpirtërore e Devollit” - vështrim studimor dhe përmbledhje folklorike, Tiranë 2014 botova 126 tekste këngësh të lirikës familjare kushtuar lindjes dhe këngës së djepit, ninullash, shifër jo shteruese. Përmbajtja e këngëve të lirikës familjare e të ninullave apo këngëve të djepit, periudhë kohore 5-6 vjeçare, sipas studiuesve të folkloristikës, ndahet në tre periudha.

Periudha e parë përfshin këngët që synonin të mbronin gruan me barrë, shtatzënë, kohën para lindjes. Në Devoll, tradicionalisht, për këtë grua thuhej “x është e rëndë”. Zakonet e ritet që kryeshin kishin qëllim të mbronin gruan me barrë nga të këqijat që mund ta gjenin dhe, sidomos, prej “syrit të keq” për të pasur lindje pa rreziqe për shëndetin, ardhjen e qumshtit të nënës së re e vijimësinë e tij.

Periudha e dytë është faza që përfshin kohën e lindjes e pas lindjes, periudhën 40 ditore e muajtë kur i/e lindura ishte foshnjë pra moshën 0-1 vjeç. Është periudha e të kënduarit të ninullave. Këtu përfshihen ceremonia e ditës kur vihet emri, “Dreka e Lindjeve”, dhe momente të rëndësishëm në jetën e fëmijës si periudha kur nisin e dalin dhëmbët, qethja e flokëve, ngritja në këmbë, fillimi i të ecurit e të folurit, është fazë e pasur me këngë e të larmishme

Periudha e tretë, këtu përfshihen këngë me vargje që përcjellin mesazhe dashurie e përkëdhelie, zbavitëse e humori, i përkasin moshës 3-5 vjeç. Përmbajtjen e këngëve të Lindjes në Devoll mund ta grupojmë në dy lloje:

- a. Këngë me përmbajtje rituale.
- b. Këngë e rituale me përmbajtje magjike.

Së fundi, gratë, si kudo edhe në krahina të tjera, janë krijueset e interpretueset e të gjithë këtij thesari. Kalimi ndër shekuj gojë më gojë patjetër që ka bërë që ato nuk na vinë si u krijuan në origjinën e hershme por shumë janë harruar, të tjera të gjymtuara po janë edhe plot të tjera të pasuruara e të lindura në vijimësi në kushte të reja politike, ekonomike e sociale. Sido të jetë, mendojmë që kjo pasuri mban vulën e grave çka të të bën të mendosh që ato mbajnë vulën e zanafillës prej matriarkatit.

2.2. MBETJE PREHISTORIKE NË VARGJE TË KËNGËVE

Çdo popull ka identitetin e vet. Nga pikëpamja leksikore kjo fjalë nënkupton tërësinë e të përbashkëtave etnike, të mësuar si etnose orale, fizike, sociale etj. të një kombi, d.m.th, vecoritë dalluese që e veçojnë nga të tjerët. Gjatë zhvillimit të shoqërisë primitive njeriu shijonte, por dhe vuante nga përballjet me natyrën. Besimet që lindën janë dëshmi e dobësisë, e paafësisë së tij ndaj natyrës në përpjekjet e tij për kapërcimin e vështirësive e marrëdhënieve që krijoheshin gjatë jetës kundër saj. Në këto rrethana filloi të kërkonte më shumë prej saj, por ajo kishte pak mundësi, ndoshta, e prej mjeteve të paka të punës, nivelit, llojshmërisë e cilësisë së ulët së tyre. Të gjitha këto do të ndihmonin për t'i siguruar kushte më të mira jetese, më tepër ushqime, veshje etj. si edhe mund ta mbronin nga dukuritë atmosferike e, në tërësi, do t'i jepnin më shumë siguri për jetën.

Historikisht, kështu lindën kultet pagane, u himnizua natyra e dukuri të saj, lindën besime me bazë shumë perëndi. Në formimin e njeriut të lashtë zinte vend ekzistenca e shumë shpirtërave. Në momentet e lindjes të shoqërisë njerëzore banorët prehistorik mendonin se bota ishte e mbushur me shpirtëra të mirë e në të këqinj. Shpirtërave të mirë u luteshin t'i ndihmonin në jetë, t'i ruanin nga të këqijat, sëmundjet, vdekja, thatësira, përmytjet, t'u falnin pjellori njerëzve, tokës, bimëve, kafshëve, vreshtave etj. Njerëzit mendonin se pranë tyre jetonin e shpirtëra të këqinj, d.m.th, të liq, ziliqarë, hakmarrës, kapriçozë, të pangopur që dërgonin sëmundje, vuajtje, vdekje, bënin të mungonte uji, të mbjellat e prodhimet të mos ishin të mbara, pengonin shtimin e blegtorisë, pakësonin gjahun, etj. Në këtë stad zhvillimi, njeriut primitiv nxorri në skenë magjistarët. Nga ritet primitive e magjike të deklamuara nga magjistarët në formë lutjesh, yshtjesh, magjish etj, “kanë lindur krijimet e para folklorike, mitologjia parapagane, pra, të jetës prej lindjes, ninullave, problematikës së gjithanshme të jetës deri në varr. Midis këtyre dy caqeve, pothuajse çdo rrethanë e rëndësishme kishte repertorin përkatës (diçka nga jehona e atij repertori, duket se na ka arritur nëpërmjet traditës popullore)”. Në kulturën shqiptare “ai mund të ketë rrënjë të një ngjashmërie apo përafërsie me parahistorinë e popujve indioevropianë, mesdhetare, euroaziatikë, etj.¹⁰ Ritualet tona fshehin misterin e fesë pagane.

Shoqëria primitive që ka jetuar në territorin shqiptar karakterizohet nga një ndjeshmëri dhe kultivim shpirtëror i veçantë, por dhe një adhurim ndaj natyrës dhe fenomeneve të saj. Perënditë e tyre ishin Toka, Qielli, Malet, Fushat, Uji, Zjarri, Guri, Dielli, Hëna, dhe Yjet. Akoma edhe sot në banorët në veri e në jug të vendit tonë betohen “Për kyt Tok dhe për at Qiell”, apo “Për kyt Zjarr dhe këtë Ujë”. Betohen e për diellin e hënë duke thënë: “Për këtë Diell dhe për këtë Hënë”. Në fjalorit të gjuhës shqipe, miti është lloj i veçantë i krijimtarisë gojore popullore, rrëfenjë për qenie të mbinatyrshme, për heronj legjendarë, për ngjarje e dukuri të çuditshme, ku pasqyrohen parafytyrimet primitive të njerëzve për prejardhjen e botës e të jetës mbi tokë, për natyrën e shoqërinë; rrëfenjë e trilluar, për diçka që nuk ka qenë e nuk është në të vërtetë, përrallë, legjendë.” Pasuria e miteve, mitologjia, është tërësia e miteve të një populli pasqyrimi fantastik i botës në ndërgjegjen e njerëzve në periudhat më të hershme të jetës së popujve si përpjekje e parë për të shpjeguar dukuritë e pakuptueshme të natyrës e të shoqërisë”.

Ritet e ritualet kontribuojnë në formimin e një identiteti të përbashkët, duke i lejuar çdo komunitet t'i shërbejë traditës dhe historisë së kombit të tij. “Me anë të ritualit përforcohet ndjenja e besimit, lidhja shpirtërore me hyjnoren, ripërtërihet kujtesa mbi domodoshmërinë e zbatimit të kodit të besimit, me një fisnikëri e përkushtim të veçantë. Në rite shprehen simbolikisht idetë më të përgjithshme, si kërkesa ndaj hyjnores për mbrojtje nga fatkeqësitë, për mbarësi, për begati në ekonomi dhe mirëqenie në jetën familjare. Pra, në rite veprohet praktikisht e kërkohet të përmbushen synime të caktuara, të thuash

10. M. Tirta “Mitologjia ndër shqiptarë”, Tiranë, 2004, fq. 13.

konkrete”. A. Uçi, akademik, mendon që mitet “nuk ishin vetëm një lojë pa kuptim e imagjinatës, por përdorej për të shprehur diçka më të thellë, përpjekje për të hyrë në kuptime të reja për të shprehur antimonitë themelore jetë, vdekje, lumturi, fatkeqësi”. Përsa i përket periudhës kur lindën ritet apo ritualet S. Selimi pohon: “*Ritet nuk janë gjë tjetër veçse forma shprehëse organizimi që predikojnë një fe të veçantë në stadi shoqërorë të caktuar, duke filluar nga jeta primitive deri tek shoqëria e lartë moderne*”. Ndërsa, akademiku M. Tirta mendon që “Ritet i kanë rrënjët në kohë të lashta, duke pasqyruar shkallë të ndryshme të mendësisë së bashkësisë shoqërore paraprake. Ritet apo praktikat rituale, të çfarëdo synimi qofshin ato, shprehin në mënyrë të qartë lidhjen e vartësinë, frikën e adhurimin, lutjen, ndaj forcave të mbinatyrshme, të paracaktuara e krejt të panjohura, ose ndaj atyre të “njohura”, animistike, hyjnore”. Ritualet tona fshehin misterin e fesë pagane. A. Stipçeviç pohon se kjo vihet re në: “paraqitjet grafike të simboleve të ndryshme, në objekte balte ose metalike, zbulojmë objektin kryesor të kultit të ilirëve, parahistorike, Diellin”.¹³⁸

Zakone, jo shteruese, po prezantojmë më poshtë:

Ja shembuj vargësh në përmbajtjen e këngëve të lindjes në Devoll, që hasim trashëgimi të tilla. Besimi fetar i paganizmit aktualisht është trashëguar e ruajtur, përgjithsisht mirë. Familja devollite ka bërë kujdes për gruan shtatzënë e lehonë dhe foshnjën e lindur dhe mirërritjen e fëmijës. Në jetë ishin bërë normë e zbatoheshin zakone e ceremoni me origjinë të lashtë ku gjatë realizimit të tyre interpretoheshin lloj lloj ritesh e rituale. Ky komunitet, më vonë, rrjedhojë e ndikimit të feve monoteiste, u vu nën trysinë e tyre dhe nisi të kryejë ceremoni e rite të rinj. Secili kryhej në kohë të caktuar të jetës në familje, ndër to, edhe të kësaj lloj të lirikës familjare. Ja disa zakone të ruajtura:

1. Për gjatë dyzet ditëve lehonës i ndalohej të dilte nga shtëpia etj.
2. Familjarët mbanin sekretin e lindjes që lehonë të mos vuante gjatë lindjes.
3. Lajmin e lindjes ndër të afërm e jepte fëmijë djalë me nënë e baba gjallë.
4. Gjithkush që shkonte për të uruar zbatonte zakonin që vizitat bëheshin vetëm ditën.
5. Vizitorët, nuk e takonin lehonën, sepse sipas bestytisë, asaj mund t’i ikte qumeshti i gjirit.
6. Gruas lehonë për dyzet ditë i ndalohej të fuste duartë në ujë.
7. Prindërit e gruas lehonë e të afërmit që vinin në Dreken e lindjeve duhet të sillnin dhurata.
8. Familjet emrat i vinin në vartësi të festave fetare.

2.3. PËRSHKRIMI I CEREMONISË “DREKA E LINDJEVE”

Ceremonia zhvillohej ditën kur foshnjës t’i vihej emri. Këtu është fjala për krenimin që kryenin besimtarët muslimanë, sepse të krishterët praktikonin zakone të fesë që besonin, ditë që, ndonjëherë, për shkaqe të ndryshme, ndodhte dhe pas disa muajsh pas lindjes së fëmijës. Familjet drekën për vënien e emrit të fëmijës së lindur e shtronin ditën e pestë a të shtatë pas lindjes dhe ftoheshin pak njerëz nga familja e nënës së re, si babai, nëna, vëllaj apo vëllezërit e ndonjë tjetër, të cilët bashkë me njerëzit e babait të fëmijës bëheshin rreth 15-20 vetë. Të ftuarit e darovitnin fëmijën me veshje, pa përjashtuar rastet me para. Dreka shtrohej në Oda të mëdha e të pranishmit uleshin në sofra të mëdha. Njëra pas tjetrës sevizeshin gatimet që ishin përgatitur, natyrisht me llojshmëri e cilësi të mirë. Në fund shtrohej ëmbelsira, tradicionalisht, ishte revania, po kishte raste ku servirej edhe bukuvale gatim i përzgjedhur ëmbëlsirash i guzhinës së grave devollite. Momenti kulmor i zhvillimit të krenimit të “Drekës së Lindjeve” ishte çasti i vënies së emrit fëmijës. I zoti i shtëpisë ftonë të diskutohet rreth emrit që do t’i vihej fëmijës. Në përgjithësi fëmijës i vihej një emër që plotësonte kushte mirëkuptimi për të dy palët se sa plotësohej dëshira e prindërve të tij. Përgjithësisht, variantet që ndikonin në përzgjedhjen e emrit, ndër më parësorët, ishin:

1. Emri të ishte me origjinë fetare si p.sh: Muhamed, Aishe, Fatime, Hysen, Hava, Hasan, Ali, Nevruz, Nevruze, Ramazan, Ibrahim, Bajram, Kadrie, Kadri etj.

2. Emri që njeri nga gjyshet a gjyshërit donin ta ripërtërinin sa ishin gjallë.
3. Emri i ndonjërit prej prindërve të fëmijës që nuk ishte gjallë.
4. Emri që përmendej në historinë e krahinës apo në atë kombëtare për virtute pozitive si urtësi, mençuri, trimëri, pra një emër personaliteti historik të njohur, etj.
5. Emri i ndonjë të afërmi prej familjeve, djalit a vajzës, që kishte vdekur në moshë të re.
6. Emri i ndonjë gjyshi a gjysheje të prindërve të fëmijës së porsalindur.
7. Emri i ndonjë fëmije paraardhës që vite më parë kishte vdekur, etj.

Do të ndalemi në një rast, që mbështetur nga përmbajtja, mendojmë se është me origjinë pagane. Në familjet e krahinës, kur në një familje njeri pas tjetrit, kishin vdekur fëmijë fëmijës që lindëte i vinin emër që lidhej me një traditë të lashtë pagane. Këtu ndikonte bestytia e ruajtur sipas së cilës besohej që Toka-Nënë ka në gjirin e saj sende apo metale të fortë, që po t'u vihen njerëzeve, mund të jetojnë. Ky ishte shkaku që viheshin emra me rrënjë HEKUR, GUR e JETE, si Hekur-an, Gur-ali, Gur-adem, Gur-tali e për femra: Hekur-ie, Gur-ije, Ymer, Ymer-li, Ymër-lie etj. Në vijim të ceremonisë vazhdohej me thyerjen e një luge sipër fytyrës së fëmijes e vazhdohej me kalimin mbi gojë të foshnjës disa herë majtas-djathas të kockës së kofshës së pulës apo gjelit të therur, sipas seksit të fëmijës. Pra, përdornin sende të fortë: lugë e kocka, sepse dëshironin që fëmija kur të rritej të bëhej i tillë.

Në vijim kryhet riti sipas zakonit: merrej një lugë bukuvale e cila mbështillej me një copë lecke e i jepej formë trekëndeshi, hajmalije dhe një nga gratë e qepte në povoj me të cilin lidhej fëmija. Ky rit kryhej sepse besohej që foshnjën do ta mbronin nga syri i keq. Në këtë ceremoni të vogël familjare nuk shtrohej raki përveçse rasteve të rralla. Të tillë quheshin rastet kur një çift lindte fëmijë pas një kohe relativisht të gjatë, pas disa vdekjeve njëra pas tjetrës, lindja e një djali pas disa vajzave etj. Në këto raste, pjesëmarrja në ceremoninë e “Drekës së Lindjeve - Vidjeve” ishte e madhe e me saze, shtrohej raki e ngrihej dolli dhe vlonte kënga e vallja e bukur devollite. Zgjedhëm për të treguar pikërisht zhvillimin e kësaj ceremonie, sepse siç mund ta ketë vënë re lexuesi i vemendshëm, në përmbajtjen e saj hasim praktikimin e një sere zakonesh, ceremonish të vogla, rituale e lëvizje që kryhen në pajtim me plot bestytini, që janë pasuri shumë e hershme shpirtërore e trashëgimisë kulturore të ruajtur në Devoll.

2.4 RITE E YSHTJE ME PËRMBAJTJE MBROJTJEN E SHËNDETIT TË LEHONËS E TË FËMIJËS-QËLLIMI I KRIJIMIT E MËNYRA TË INTERPRETIMIT TË TYRE

Ritet me përmbajtje sipas qëllimit pse kryeshin, janë përdorur, sidomos, për shërimin e sëmundjeve nga të rënit më sy apo trembjes, frikës për të shpëtuar nga rreziqe të mundëshme. Këto formula janë mbajtur sekret e përpara të sëmurit thuhet nëpër dhëmbë, mbyturazi, pa i kuptuar njeri, me bindjen se kështu kanë efek shërues. Shumica e yshtjeve recitohen shoqëruar me gogësima, me të prekura shoqëruar me fërkime dhe fryrje ajri. Fjalori i përdorur gjatë yshtjeve është arkaik që vërteton hershmërinë e tyre, ndërsa në ndërtimin e fjalive përdoren më dendur metafora, antiteza, eufemizma (fjalë e shprehje që përdoren në vend të një fjale tjetër që nuk duam ta përdorim ose nuk duhet t'i zemë në gojë) etj. Yshjtet, sipas kujtesës popullore, thuhet shumë herë, zakonisht, deri 3-7 herë.

Në Devoll këtë punë, tradicionalisht, e kanë kryer gra të moshuara që ia kanë mësuar nënat e tyre dhe e paditur shkonin, tek këto ilaçtare njerëzit e paditur, tek-tuk shkojnë edhe sot, për t'u yshtur me besimin se sëmundja apo shqetësimet që kanë do të largohen prej tyre rrjedhë e ndërhyrjes së fuqive të mbinatyrshme. Formulat e riteve e të zakoneve që përdoren pas lindjes kanë karakter të theksuar magjik dhe në thelb ato kryeshin për të mbrojtur fëmijë nga “syri i keq apo edhe i lig”. Prindërit, rrjedhë e paditurisë, besonin që të këqijat, sëmundjet, pasojat e liga që i kishin zënë, pra, shqetësimet familjare, do të largoheshin nga ndërhyrja e fuqive të mbinatyrshme. Në përmbajtjen e riteve e të

yshtjeve ze vend përdorimi i disa sendeve që sipas besimit pagan, kishin forcë vepruese, uji si forcë e fuqishme pastruese; zjarri për forcën përvëluese të flakëve, sende metalike, masha, perustia, etj., për forcën e tyre; kripa për fuqinë e saj e zhurmën që çlironte gjatë djegies në zjarr, etj. Po rendisim disa rituale e yshtje që sipas bestytnisë kryenin interpretueset me besimin se do të parandalonin apo do të veprimtarinë e “syrit të lig”.

1. Kushdo që e shihte fëmijën për herë të parë duhej ta pështynte atë lehtë dhe të shqiptonte me zë të ulët togfjalëshin: “Ptu, mashallha”.
2. Kur fëmija grindej pa pushim a qante shpesh, familjarët, pa u përpjekur të gjenin shkaqet mendonin që foshnja kishte rënë më sy. Pra, kjo kishte ngjarë, sepse ndonjë që kishte ardhur gjatë ditës e kishte parë e përkëledhur fëmijën, duke e parë në fytyrë që ia kishin lënë zbuluar. Jo vetëm për këtë rast, por për shumë të tjerë për të larguar, plasur pasojat e “syrit të lig”, kryheshin disa rituale.
3. Përgatitsja merrte nga vatra e zjarrit një thëngjill dhe e shuante me pak ujë në një filxhan. E linte sa të kullonte mirë e mirë e pataj ia jepnin fëmijës për ta pirë.
4. Një nga gratë e familjes merrte pak kripë e treste në pak ujë dhe e mblidhte me një leckë në formë hajmalije, e linte sa të kullonte dhe ia jepnin fëmijës për ta pirë.
5. Kishte raste që me hajmalinë vepronin, si më sipër dhe pastaj e hidhnin në zjarr duke thënë: “Pëlçit, o syri i keq, ashtu siç pëlçet kripa në zjarr”.
6. Familjarët përgatisnin më parë një hajmali, e pse fëmija nuk kishte probleme shëndetsore, ia varnin në qafë si mase parandaluese për të mos rënë me sy.
7. Një grua nga familja a ndonje tjetër merrte pak kripë, e mbështillte me një leckë në formë hajmalie, dhe e kalonte tri herë mbi fytyrën e fëmijës. Pastaj e qepnin poshtë povojit, rrip leshi që lidhej fëmija me djepin, dhe e linin sa fëmija të përmirësohej.
8. Në muajtë e parë së jetës, vetëm për fëmijën djalë, zhvillohej një ritual me përmbajtje të thjeshtë: në mes të odës, përpara djalit, vendoseshin sende pune si sqepar, mistri, bizë, revole, gërshërë etj. Pjestarët e familjes, tërë kërshëri, ndiqnin lëvizjet e fëmijës, sepse besonin që objekti, mjeti i punës, që do të merrte përcaktonte llojin e punës që do të bënte kur të rritej.
9. Nëna, sa herë ia ndërronte këmishën foshnjës, duhej patjetër që ose t’ia ndërronte rrobat e trupit, ose këmishën që ia vishte t’ia përthyente, nga pak.
10. Fëmijës djalë, kur niste të jepte shenja se do të ngrihej në këmbë, pra, fillonte të ecte, kryhej rituali me këtë përmbajtje: i vinin mbi shpinë, në kurriz disa dru të holla, shkarpa, dhe e rrotullonin tri herë rreth e qark shtëpisë. Ky veprim kryhej nga një i rritur i familjes, i cili e bënte duke e shoqëruar fëmijën me kujdes e mbajtur për dore.
11. Ditën e Verës, veçanërisht, fëmijëve u vinin në dorë verore (fill i përdredhur me fije peri të kuq e të bardhë) që ditën e Shën Gjergjit ia hiqnin dhe i varnin në degë pemësh që kishin filluar të jeshilonin me herët se të tjerat, si shelgu, kumbulla, etj. praktikoheshin dhe hedhja mbi çatinë e shtëpisë.

2. 5. Gjuha shqipe bijë e ilirishtes, pjesë e familjes së gjuhëve indoevropiane, mbetje në fjalë e në forma fonetike dhe morfologjike në këngët e lindjes e të elementeve të saj.

Sh. Demiraj thotë: “Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve i.e (indoevropiane), d.m.th., në atë familje gjuhësh me burim të përbashkët që qysh nga kohërat e hershme parahistorike janë folur në trevat nga India në Evropë.¹¹ Ajo është “Gjuhë e familjes së gjuhëve indoevropiane; formon një degë më vete në këtë familje dhe nuk rrjedh prej asnjërës nga gjuhët e sotme të saj. Një pjesë e mirë e leksikut e

11. Sh. Demiraj “Gjuha, vepër e cituar, fq. 19.

elementet themelorë të strukturës gramatikore të shqipes janë trashëguar nga një periudhë e lashtë e gjejnë analogji e përkime në gjuhë të tjera indoevropiane.¹²

G.V. Laibnic, sipas E. Jacques, që kur shkruan për origjinën e gjuhës e të popullit shqiptar, pohon se është njohur me një letër të shkruar prej tij. “Në letrën e tij të 10 dhjetorit 1709, e cituar më 1897 në revistën rumune Albania, deklarohet se studimet e tij të librave shqip, midis të cilëve edhe një fjalor, e bindën (Laibnicin-H. K.) se “shqipja është gjuha e ilirëve të lashtë.”

F. Bopp-i, është ndër të parët që në vitin 1854, deklaroi përfundimin se “kjo gjuhë, d.mth., gjuha shqipe, me të vërtetë i përket në mënyrë të sigurtë familjes indoevropiane, por në elementet e saj themelorë nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë, ose, aq më pak, ndonje lidhje prejardhjeje me asnjërën nga motrat sanskrite (=indoevropiane) të kontinentit tonë”.

H. Tumnan, albanolog që studioi shkencërisht prejardhjen e gjuhës shqipe. Në vitin 1774 deklaroi: “Në historinë e tyre (Ilirëve-H.K.) nuk kam gjetur ndonjë gjurmë të ndonjë emigracioni të mëvonshëm: pra, gjuha e tyre na ka dhënë të tilla dëshmi për faktin e këtij populli, sa unë nuk mund të mos njoh te ky fqinjët e lashtë, të Grekëve e nënshtetasit e Romës së Vjetër. Po të dyja këto më tregojnë Ilirët.

J. Han: “Gjuha shqipe është vazhduese e drejtpërdrejt e ilirishtes, kurse vetë ilirishtja rridhte nga pellazgjishtja”.

G. Williams: “Shqiptarët janë të vetmit që kanë ardhur deri më sot nga kjo racë e fuqishme parahistorike. Vetëm vitet e fundit është përcaktuar se Pellazgët kanë qënë Ilirët e lashtë.”

A. Stipçevic: “E kaluara dhe kultura e ilirëve është pjesë përbërëse e historisë kombëtare... mbi të gjitha e shqiptarëve për të cilët sot mund të thuhet se, edhe shkencërisht, është vërtetuar prejardhja e drejtpërdrejtë e tyre nga ilirët e vjetër.¹³ Në vijim po renditim emra studiuesish të njohur që kanë pohuar se tezën e prejardhjes së shqiptarëve nga ilirët e të shqipes nga ilirishtja: G.V. Laibnic, G. Meyer, E. Shnajder, H. Pedersen, K. Jensen, N. Jokli, M. Lanberci etj.

Në pasurinë e këngëve të lindjes e të ninullave, përveç argumenteve që renditëm, për burimin e gjuhës së tyre jami konsultuar shkrime shkencorë, pohime fjalësh të hulumtuar në tema, kumresa, referate, mbajtur në simpoziume, konferenca, kuvende kombëtarë, me punën studimore madhore të albanologut të njohur, E. Çabejt, me veprën e akademikut K. Topalli “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2017 si edhe fjalë të pohuara me burim nga parailirët apo ilirët nga studiuesit Sh. Demiraj, M. Domi, Dh. Konda, A. Kola, Dh. Pilika, M. Arefi, N. Çabej, A. Spahiu, S. Mancaku, etj. Burimi i gjuhës së shumicës dërrmuese të fjalëve të përdorura në këtë pasuri të lirikës familjare në Devoll, të cilat janë, emra, përemra, mbiemra, numërorë, ndajfoje e fjalë lidhëse etj., janë pohuar si njësi leksikore të trashëguara nga ilirishtja “nëna” e gjuhës shqipe apo të formuara gjatë zhvillimit të saj të brendshëm gjatë etapave të zhvillimit të saj ndër shekuj. Theksojmë, nga studimi i fjalëve të përdorura në këtë pasuri shpirtërore folklorike të Devollit ndeshim forma fonetike e forma morfologjike, që janë shprehje e konservimit të formave arkaike të shqipes, të cilat pohojnë jo vetëm vjetërsinë e saj por edhe origjinën e lashtë të përdoruesëve të saj.

Përsa i përket fjalëve të përdorura, por të pohuara shkencërisht që janë me burim nga fondi i trashëguar indoevropian apo lindura nga zhvillimi i saj i brendshëm, po citojmë vetëm disa, si ndër më të përdorurat në këngët e lindjes e në ninullat, sepse numëri i tyre në këtë pasuri të lirikës familjare është me qindra. Të tilla janë: yll, zot, diell, dritë, natë, re/reja, shi, hënë, jetë, ujë, lumë, det, rosë, zogë, e-ëmë/a, ballë/i, bir, bijë, vajzë, vëlla, burrë, plak, nuse, gji, gju, qumësht, prehër, bletë, buzë, darkë, dash, dorë, dem, derr, dosë, dre dhelbër, dhi, dhëmb, eshtër, gjemb, gjizë, fletë, lopë, viç, kos, sy, gur, mal,

12. Fjalori Enciklopedik..., vepër e cituar, fq. 860.

13. N. Dragoi “Shqiptarët dhe Grekët”, Tiranë, 2009, fq. 30.

punë, qafë, trim, zjarr, mbiemrat, i lig, i gjatë, i lehtë, i madh, i vogël, i zi, etj. Në vijim shkruan: “Numërorët gjuha shqipe i ka trashëguar nga një fazë e hershme indoevropiane”. Dhe për foljet pohon: “Në shqipen e dokumentuar janë përdorim edhe një numër i madh foljesh të trashëguara nga një periudhë e hershme indoevropiane”. Në vijim shkruan: “Shqipja ka edhe një numër jo të vogël fjalësh shërbyese të trashëguara nga një fazë e hershme indoevropiane, siç janë parafjalët (te Buzuku, Budi, etj.), ndë/në, mbi, me, pa, për, prej, etj, lidhëza me kuptim përemëror se, si, sa, që, ku etj.”

Vargje kushtuar Zotave, perëndisë:

“Ori, oriri / shyqyr moj perëndi, / që më dhe këtë flori! / O shyqyr, moj **perëndi**, / që ma mbushe këtë shtëpi.” Devoll

“Hajdeni të hamë bukë! Gishti i dytë i thotë:/ Me se ?/ I treti, i mesmi, thotë:/ Me se ka dhënë perëndia”- Vidëhövë

Vargje me përmbajtje hyjnizimin e trupave qiellorë, si hëna, yjet e retë:

Re re, bobo re,/ Lëshona **diellin** përdhe,/ Se të lëshonj macen,/ Se të hanjë kulaçen.”-Devoll.

Ç’u këput një yll pe **qelli**,/Lum kush e pa,/Ç’u këput e ra pas fshatit,/Vate kondisi dë gju të të atit.”- Dardhë.

Nani-nani-na, çup’e nënës-o,/Të më rritesh si drit’e **hënës-o**.”/Puntore e fortë posi bleta’/Gojëmjaltë, krahëlehta-o.- Miras.

“Fli gjum të ëmbëlë, të më bëhesh nusezë, E bukur si **hënëzë**.”-Menkulas.

“**Hënë, hënë**, kokohënë, Babanë tënë?/Se na vajti dë kurbet, Të na vijë me shëndet.”-Hoçisht

“**Hënë, hënë**, perihënë,/ Shko këtej mbrëmë! / Shtrova shtranë, / Rash e fjeta,/ M’i kokë më shkovi shigjeta.” -Dardhë.

“**Re re**, kokore,/Bjerë djellë gjer përdhe,/Të ngrohemi ne të tre,/Ne të tre të mirët, Buzëkarafilët.” - Biçakaj i Ri, fshat në Lushnjë, u formua me banorë të fshatit Shag e Gërleñj të krahinës së Devollit, sot në territorin e shtetit grek.

Vargje që përmbajnë emra shpendësh: pëllumb, zog, qyqe.

Hesiodi, shek. VIII p.e.s, shkruan: “Dodona dhe lisi ishin qendra e pellazgëve”¹⁴; Homeri, shek. VIII p.e.s. duke treguar për protagonistin e “Odisesë” pohon: “Dhe thoshte se në Dodonë kishte shkuar për t’u këshilluar me Hyjin dhe për të dëgjuar nga lisi i gjatë faltarin e Zeusit...”¹⁵; Herodoti shek. V p.e.s. sjell këto imtësi pasi e ka vizituar vetë Dodonën, kryendrën e pellazëve: “...Përsa i përket themelimit të Dodonës, priftëreshat dhe faltarët e kësaj (orakullit) tregojnë këto: dy pëllumba të zinj u nisën nga Teba e Egjiptit dhe, duke fluturuar, zbritën njëri në Libi dhe tjeri te dodonasit. Ky i fundit në një dushk (lis-H. K.) dhe me zë njeriu tha se aty i duhej ngritur një orakull Zeuzit; populli këtij vendi kuptoi se kuptoi se ky lajmërim ishte nga perënditë dhe menjëherë vuri në zbatim porositë e



14. Dh. Pilika “Pellazgët-origjina jonë e mohuar, Tiranë, 2005, fq 153.

15. Po aty, fq.182.

pëllumbit...”¹⁶ Straboni aty nga viti 63 p.e.s. dhe vdiq rreth vitit 20 të e. sonë, shprehet: “Sa për legendat që fliten rreth lisit e pëllumbave dhe për të tjera si këto...”¹⁷. “*Dumba-dumba-dumba, /Lozin tre pullumba, /Të bardhët si shkumba, /Lozin e kërcejnë, / Çupkat na i rrëmejnë.*” - Ziçisht.

“*Pëllumbesha* quhet, / Nëna shpirtit i gëzonet, / Fli, o e mir’e nënës-o.”-Saravë~a, fshat në Lushnjë, u formua me banorë të fshatit Revan të krahinës së Devollit, sot në territorin e shtetit grek.

“Im vëlla nuk e priti,/E priti **pullumbi**,/**Pullumbi** e humbi,/ Gallofi e mori.”-Trestenik.

“Hajde gjum’, si **pëllumb**, / Zere djalkën, rrite shumë, / Hade gjum’ dëpër portë, / ma bëj djalkën të fortë.”-Bitinckë.

“Qeni lihte ham, ham, ham,/A e prit o Sulejman./Sulejmani nuku e priti,/E priti **pullumbi**.”Sul

“Nina nana djalkën,/Vanë **zogat** bë lumë, / I sjellin djalkës gjumë,/ Vanë **zogat** bë det,/ I sjellin djalkës shëndet.”-Dobranj.

“Më vajtnë **zoçkat** dë det, /T’i sjellnë djalkës shëndet,/ Më vajtnë **zoçkat** bë lumë,/ T’i sjellnë djalkës o gjumë.”- Shënkolas, sot Fitore.

“Seç të gjeta tët vëlla, / Që nuuronte ca para, /T’i bëjë u dolloma.”- Poloskë.

Vargje të këngëve që përmbajnë emrat lis-dushk, mal, gur.

“Moj babo, ç’bën atje?/Bënj një petë me arme. / Kujt ia shpje?/Sime bije. / Ç’bëri?/Djalë. / Si ia vutë emrin? / Fletë **dushku**.”- Dardhë.

“Ç’u bë macja?, / Hipi dë **list**. / Ç’u bë bë **lisi**? / E pref sëpata.”-Sinicë

“Pyr, pyr, pyr, pyr bekëza,/Vajta për purtekëza,/Putekëza nuku gjeta, / Gjeta drutë e **malit**-ë, / Ja ngarkova kalit-ë.” Çipan

“Ç’u bë sëpata? / E thef **guri**, / Ç’u bë **guri**? / E mori lumi.” Devoll.

Vargje të këngëve që përmbajnë emra kafshësh: viç, kos, dhi, dhëlpër.

“M’u bëfsh baraz me një **viç**,/ **Viçi** na u bëftë ka, / Djalka u bëftë pasha,./”- Dardhë

“Tym, tym, kokolos, / Shko përprjetë të hash **kos**, / Të hash **kos** edhe kulaçe, / Të të rrahin me kopaçe.”- Biçakaj i Ri, burim i qaruar.

“**Dhi**-dhi me një bri, / I jap ujë e s’më pi, / I jap bukë e s’më ha, / Them ta bëjmë pastërma! / Pastërma nuku më sos,/ them ta nakatos me **kos**” -Baban

“Ikë, o moj **dhëlpër**, ikë, /Më të përprjetë si thikë.” – Ziçisht.

“O moj **dhëlpër** filingore, /Nëma pulën që ma more,/ Ce e kisha amaçkë,/ Ce desha ta vinja kuaçkë.” – Ziçisht.

Vargje që përmbajnë emrat ujë, lumë, det.

“Zu e na bluan mulliri, / me tri pika **ujë** vir, / Të nëntën na e bloi, / Dhe dhjetën na e shteroi; / Vate plaka e lëshoi.”- Shyec

“Nani, nani, more bir,/ Fli ce gjumi të bën mir’! / Shkojnë rosat bë **lumë**, / që t’i sjellin djalit gjumë.”- Qerret i Ri, fshat në Lushnjë, u formua me banorë të fshatit Prapackë e Oshanj të krahinës së Devollit, sot në territorin e shtetit grek.

“Djalkën ma zuri gjumi, / më ia marrtë **lumi**, / Zere gjumë e mbaje shumë, / Ce pastaj e sqonj unë.”- Biçakaj i Ri, Lushnjë, rast i sqaruar.

“Nano-nano ta zerë gjumi, /Të ligat ia marrtë **lumi**, / Na vanë zogat bë lumë, / t’i sjellin djalkës gjumë.”- Braçanj.

16. Po aty, fq. 222.

17. Po aty, fq. 183.

“Zoga, që më shkoni bë lumë, / Djalit m’i sillni gjum, /Zoga që shkoni dë det,/ Djalkës më sillni shëndet!”-Bozhgrad, sot Miras.

“Nani nani çupënë,/çupë bukuroshen-o,/Nani t’ma zerë gjumi,/Të ligat i martë lumi.”-Grapsh.

Ruajtja në përdorim e fjalëve të hershme shërbyese mbetje gjuhësore të formave të arkaike të konservuara në leksikon e banorëve të Devollit, si parafjalët **ndë** për në, **dë** për në, **bë** për në, **pe** për prej, **fjala nuku** për jo, përemri pyetës **ce** për pse. Gjithashtu, shtojmë që në fjalorin e fjalëve të përdorura në këngët e lindjes e të ninullave haset edhe përdorimi i qindra e qindra formash fonetike fjalësh, që rrjedhimisht ndikuan në dukuri morfologjike të fjalëve sipas të folmes të hershme leksikore të njësisë etnokulturore krahinore të Devollit. Në pasurinë leksikore të fjalëve të përdorura në vargjet e këngëve të lindjes e të ninullave-zakoneve, ceremonive e riteve, që kryen apo interpretohen nga devollinjtë shumica janë shqipe që gjuha i ka trashëguar nga “nëna” e saj, ilirishtja, e të tjera u krijuar pas formimit të vetë gjuhës shqipe, shek. IV të e. sonë. Gjuha shqipe është një nga gjuhët e gjalla, që u rrezistoi rrebesheve të kohës “Megjithë trysnitë e forta e të gjata të greqishtjes, latinishtes, sllavishtes e turqishtes shqipja, i ka ruajtur tiparet e saj thelbësore. Natyrisht, trysnitë e huaja lanë gjurmë, kryesisht, në fjalorin e saj.¹⁸

PËRFUNDIME

Me përmbajtjen e punimit tonë shkencor që argumentojmë :

1. Devolli shtrihet në territor që prej historie banohej nga Dasaretët, etni fisi të njohur ilir.
2. Përfundime për gjetjet arkologjike që pohojnë se jeta e shoqërisë njërezore në zonën e Devollit e ka zanafillën prej prehistorie (stacionet arkologjike në Shpellën e Trenit, Mesolitikum 10200-650 p.e.s., në Burimas, dikur Gollobërda, Neoliti i Hershëm, 6500-2500 p.e.s., Gradishta e Shyecit, fortifikim i Neolitit të Vonë, kalaja e Trajanit, shek. VIII-VII p.e.s., Kalaja e Ventrokut, datohet e Broxit të Vonë, në Senisht (Sinicë) është gjetur një shtizë maja e të cilës datohet e shek. VIII-VII p.e.s., zbulimi i një shtratit të një varke në Ziçisht datohet i shek. VII p.e.s etj.
3. Në “Qeramikën Devollite”, periudha e Bronxit, që lindi në Devoll e i jep vulën origjinës së vendlindjes së saj dhe zhvillimit të poçerisë në shekujt pasardhës.
4. Gjuha shqipe, ka “nënë” ilirishten, gjuhë indoevropiane dhe folës të saj janë parailirët, ilirët, arbërorët e shqiptarët e sotëm ku përfshihen edhe banorët e Devollit është gjuha me të cilën interpretohen këngët e Lindjes e të ninullave.
5. Pasuria e këngëve të Lindjes e të Ninullave, zakone, ceremoni, rite e rituale në Devoll janë trashëgimi shpirtërore e kulturore e trungut parailir-ilir-arbëror-shqiptar.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. ASH. E RP të Shqipërisë “Kuvendi i studimeve ilire”, Tiranë, 1974.
2. ASH e RP të Shqipërisë “Ilirët dhe iliria te autorët antikë”, Botimet Toena, Itranë, 2002.
3. ASH e RPS të Shqipërisë Konferenca kombëtare “Për formimin e popullit shqiptar , të gjuhës e të kulturës së tij”, Tiranë 1988.
4. ASH e Shqipërisë “Fjalorenciklopedik shqiptar”, Botim i Ri, Tiranë, 2008.
5. ASH e RPS të Shqipërisë “Çështje të folklorit shqiptar. 4”, Tiranë, 1989.
6. A. Kola “A. Kola “Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve,” Shtëpia Botuese “55”, 2002.
7. A. P LLalla “Demografi e viseve shqiptare në Greqinë e Veriut”, Tetovë, 2013.
8. A. Spahiu “Pellazgët dhe ilirët në Greqinë e vjetër”, Tiranë, 2006.

18. Sh. Demiraj, vepër e cituar, fq. 20

9. A. Stipçeviq “ILIRET-historia, jeta, kultura, simbolet e kultit”, Tiranë, 2002.
10. A. Uçi “Mitologjia, Folklori, letërsia”, Tiranë, 1982.
11. Dh. Pilika “Pellazët-origjina jonë e mohuar”, Tiranë, 2005.
12. E. Jacques “Shqiptarët”, Shtëpia Botuese “Kartë e Pendë”, 1995.
13. E. Shnajder “Pellazgët e pasardhësit e tyre”, Tiranë, 2009.
14. K. Topalli “Fjalor etimologjik I gjuhës shqipe”, Tiranë, 2017.
15. M. Aref “Mikenët=Pellazgët, Greqia ose zgjidhja e një enigme”, Plejad, 2008.
15. M. Tirta “Etnologjia e shqiptarëve”, Tiranë. 2003.
16. M. Tirta “Mitologji ndër shqiptarët”, Tirane, 2004.
17. N. Dragoi “Shqiptarët dhe Grekët”, Tiranë, 2009, fq. 30
18. M. Korkuti “ Vendbanimi prehistorik i Trenit”, Iliria I,
19. S. Selim “Folklori koreografik shqiptar”, SHLBU, 2003.
20. Sh. Demiraj “Gjuha shqipe dhe historia e saj”, Tiranë, 1988.
21. Sh. Ollomani, shkrim “Leka i Madh (Aleksandri i Madh), Shkup, 2010.